



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë
Nr. Dok. 202002210/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisarriatin e Policisë Gramsh.

Drejtuar: Kryekomisar Vullnet SILAJ
Shef i Komisarriatit të Policisë Gramsh

GRAMSH

Për dajeni: Drejtues i parë Arjan MUÇA
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan

ELBASAN

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisarriatin e Policisë Gramsh.

Inspektimi u krye në datën 11.02.2020, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

¹ Neni 81 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e komisariatit z.Vullnet Silaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Shefi i Komisariatit, informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, zbatimin me korrektësi të akteve ligjore e nënligjore dhe konventave ndërkombëtare, që garantojnë mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit i shoqëruar nga shefi i komisariatit dhe punonjësit e zyrës së informacionit, vijoi inspektimin e kushteve në të cilën ndodhet ambienti i shoqërimit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Drejtuesi dhe punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Gramsh, me të cilët u kontaktua, u treguan bashkëpunues dhe transparentë gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi grupi i inspektimit në këto ambiente.

Nga informacioni i grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit rezultoi se, gjendja fizike e godinës së komisariatit dhe kushteve në ambientin e shoqërimit ishte e njëjtë si në inspektimin e mëparshëm, krahasuar me standardet e parashikuara në aktet ligjore e nënligjore dhe dokumentat ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar apo të ndaluar/arrestuar në mjediset e policisë.

Ndërsa, nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi mëparshëm, rezultoi se:

1. Ishte krijuar një **dhomë (zyrë) për marrjen në pyetje/intervistimin** e personave të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar nga punonjësit e policisë në mjediset e këtij komisariati.
2. Punonjësit e policisë në **zyrën e informacionit ishin trajnuar**, me qëllim plotësimin e plotë dhe me korrektesë të të gjithave rubrikave të regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar.

Ndërkohë, nuk kishin gjetur zbatim rekomandimi i mëposhtëm:

1. **Nuk ishte instaluar sistemi i monitorimit me kamera** në ambientin e shoqërimit dhe në dhomën e marrjes në pyetje/intervistimit të shtetasve të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar.

Në përfundim, grupi inspektimit konstatoi se, megjithëse në Komisaratin e Policisë Gramsh ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me kushtet materiale dhe të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Gramsh, ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 306 datë 31.03.2016.

Ambienti i shoqërimit ndodhej në katin e parë të godinës të komisarlatit. Ky mjedis përbëhej nga 3 (tre) dhoma shoqërimi për mbajtjen dhe trajtimin e personave të shoqëruar, nga të cilat 1 (një) dhomë për personat e rritur, 1 (një) për femra dhe 1 (një) për të miturit.

Sipërfaqe dhe hapësira e dhomave të shoqërimit ishin të bollshme për qëndrimin dhe trajtimin e të shoqëruarve, si dhe të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, me kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ligji iu njehtë këtyre personave.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të lyera, të pastra nga ana higjieno sanitare. Për shkak të amortizimit të godinës, ambienti i shoqërimit dhe ambjentet e zyrave të punës, kishin lagështirë dhe ndihej erë e rëndë e mykut.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit ndodhej vetëm një tualet i përbashkët për meshkuj dhe femra, i cili kishte ujë të rrjedhshëm në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje.

Në ambjentin e shoqërimit ishte krijuar një zyrë pune për specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë, e cila shërbente si dhomë për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në mjediset e këtij komisarlati.

Por, grupi i inspektimit konstatoi se mungonte sistemi i monitorimi me kamera për mbajtjen në vëzhgim të korridorit dhe ambientit të shoqërimit, si dhe zyrës ku merren në pyetje personat e shoqëruar.

Mungesa e sistemit të monitorimit me kamera, kryesisht në dhomën për marrjen në pyetje të personave të shoqëruar, mund të përbëjë shkak për përdorimin e mjeteve dhe metodave jo të përshtatshme për shoqërimin, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë, si dhe për respektimin dhe garantimin e të drejtave që ju njehtë ligji këtyre personave.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Ambjentet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Gramsh nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Elbasan.

Regjistri i personave të shoqëruar, si dhe trajtimi i të shoqëruarve

Gjatë inspektimit u konstatua se, në Komisarlatin e Policisë Gramsh, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar”, ishte i tipit “Model nr.1”, konform

procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme, nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.

Seksioni i rendit publik në këtë komisariat, kishte organizuar trajnim të veçantë me punonjësit e policisë në zyrën e informacionit, për mënyrën e plotësimit të regjistrit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar, në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë², sipas rubrikave.

Mangësitë e konstatuara nga inspektimi i mëparshëm, në rubrikat “Arsyet ligjore të shoqërimit” dhe “Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarve”, ishin plotësuar me korrektesë sipas ligjit. Baza ligjore e shoqërimit ishte pasqyruar sipas Kodit Penal, po ashtu edhe gjeneralitetet dhe numri i telefonit të personit familjar të njoftuar.

Në këtë Komisariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre për në organin e policisë. Kjo, u vërtetua dhe nga proces verbalet e ndalimit të personave nga punonjësit e policisë të këtij komisariati, të cilët më tej dërgoheshin në dhomat e sigurisë në Komisaratin e Policisë Elbasan, ku orari i shoqërimit përputhej me orën e ndalimit në mjediset e policisë.

Ndërkohë u konstatua se, në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën e inspektimit nuk ishte evidentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisaratin e Policisë Gramsh punonjësit e policisë i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrën e krijuar për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Sikurse e përmendëm edhe më lart, kjo zyrë dhe ambjentet e komisaritatit, nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave, për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në veçanti në këto zyra dhe ambjentet e shoqërimit, por është konstatuar se ky rekomandim nuk është plotësuar.

² Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Avokati i Popullit, duke përshëndetur krijimin e zyrës për intervistimin e personave të shoqëruar, gjen rastin të theksoj se, referuar standardeve ndërkombëtare³ e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që iu bë zyrave të punonjësve të policisë, por edhe zyrës së intervistimit nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga pyetja e punonjësve të policisë, rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit në moshë madhore, të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme ose Bashkinë e qytetit Gramsh.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e godinës ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

³ “*Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.*” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme, për rikonstruksionin e dhomave të shoqërimit të Komisarariatit të Policisë Gramsh, me qëllim eliminimin e lagështirës që ishte prezent në dhomat dhe koridorin e ambientit të shoqërimit.
2. Marrjen e masave të nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në korridorin e ambientit të shoqërimit dhe në dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar apo të arrestuar/ndaluar në mjediset e këtij komisaritati.
3. Garantimin e të drejtave procedurale të personave për t'ju komunikuar në kohën e duhur shkaqet e shoqërimit dhe garantimi i shënimit të të dhënave të sakta në aktet përkatëse, në lidhje me kohën e privimit të lirisë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Lligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA